

**AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

STUDIO LIGJORE "XHINDI"

Sot në datën 10.02.2023 (dymijë e njëzet e tre), unë Roland XHINDI atësia Fiqiri, i datëlindjes 04.11.1983, lindur në Berat dhe Banues në Tiranë Rruga "Haxhi Hysen Dalliu" Nd.89 H.3 Kati 1, mnajtës i letërnjoftimit ID: I311040150. Vendosa të themeloj Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar *STUDIO LIGJORE "XHINDI"*, mbështetur në nenin 2 paragrafi B i ligjit për "sanksionet dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë të veprimtarisë private, të pavarur dhe të privatizimit", në ligjin 9901 datë 14.04.2008 "për tregëtarët dhe Shoqërit tregëtare" i ndryshuar, në të cilin jam ortak i vetëm dhe për këtë qëllim hartoj Aktin e Themelimit, me përmbajtjen si vijon.

**NENI 1
EMRI**

Shoqëri tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet, *STUDIO LIGJORE "XHINDI"*, e cila këtu dhe më poshtë do të quhet "shoqëria". Ajo krijohet nga ortaku i vetëm themeluesi Roland XHINDI.

**NENI 2
FORMA**

Kjo shoqëri është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3
BAZA JURIDIKE**

Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridikë pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

**NENI 4
SELIA**


Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rruga "Haxhi Hysen Dalliu" Nd.89 H.3 Kati 1, pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

**NENI 5
TERRITORI**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë dhe në shtete të ndryshme në përputhje me rregullat e përcaktuara ligjore të vëndeve përkatëse.

**NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shërbime avokatie, përfaqësim Gjyqësor në të gjitha Gjykatat e shkallëve të ndryshme të vëndit dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Konsulencë ligjore dhe ç'do aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi që ka lidhje me shërbimet në fushën juridike, si konsulencë për administrimin, shitblerjen, dhënie me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të veprave civile, tregtare, industriale, publike apo private duke përfshirë pa u kufizuar në: ndermjetësim për kryerjen e veprimeve të mësipërme midis personave juridike privat apo publik, vendas apo të huaj dhe personave fizik, marketing,



shitje, menaxhim dhe zhvillim prone. Kryerjen e ç'do lloj aktiviteti tjetër që ka lidhje të drejtëpërdrejtë ose jo me përmbushjen e objektit të sipërpërmendur të shoqërisë.

NENI 7
KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 10 vjetë, duke filluar nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 8
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10.000 lekë.

Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm, Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

NENI 9
KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakut të vetëm të Shoqërisë Roland Xhindi, në vlerën 10.000 lekë.

NENI 10
PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar është i ndarë në 1 pjesë plotësisht të shlyer, me vlerë nominale 10.000 lekë.

NENI 11
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrimi i Shoqërisë do të bëhet nga një administrator. Administrator i Shoqërisë është Roland XHINDI, atësia Fiqiri, i datëlindjes 04.11.1983, lindur në Berat dhe Banues në Tiranë Rruga "Haxhi Hysen Dalliu" Nd.89 H.3 Kati 1, mbajtës i letërnjoftimit ID: I311040150.

Ai e ushtron këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare.

NENI 12
DISPOZITA TË FUNDIT

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akti themelues edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortaku i vetëm dhe si i tillë do të miratohet në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit ditën e legalizimit si person juridikë në Shqipëri.

Ky akt themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën Shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

Themeluesi

Roland XHINDI

